

KËRKESË PËR OFERTË
Procedura për kuotimin e çmimeve

Numri kërkesës për ofertim:	ICK-CLF-2020/028
Data e publikimit	15 Qershor 2020
Data e mbylljes:	24 Qershor 2020
Titulli i kontratës:	Procesi i Monitorimit dhe Raportimit të Përfituesve të thirrjes së 3-të të Fondit të Inovacionit
Autoriteti Kontraktues	Innovation Centre Kosovo, ICK
Adresa:	Rr. Rexhep Mala 28A, 10000 Prishtinë, RKS
E-mail:	finance@ickosovo.com

PËRMBLEDHJE

Innovation Centre Kosovo (ICK) fton subjektet (persona fizik apo juridik) e interesuara të paraqesin ofertat për:

- Procesi i Monitorimit dhe Raportimit të Përfituesve të thirrjes së 3-të të Fondit të Inovacionit

Projekti financohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH. Projekti ngërthen në vete shumë aktivitete dhe ka dy komponenta kryesore: zhvillimi i ndërmarrësisë TIK dhe mbështetja e ekosistemit sipërmarrës në Kosovë duke ofruar shërbime të ndryshme biznesi si dhe grante për startup-at dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të angazhuara në ide inovative dhe ofrimi trajnimeve të dedikuara për gratë në zonat e identifikuara si kërkesa të mëdha. Kjo do të krijonte një gjeneratë të re të profesionistëve femra me përvojë për të kënaqur nevojat dhe aspiratat e eksportit të kompanive të Kosovës për të qenë më konkurrues dhe të orientuar drejt eksportit.

Kompanitë/Konsulentët duhet të ofertojnë sipas kërkesës të paraqitur në këtë dokument dhe termave të referencës të bashkangjitur.

KUSHTET E DETYRUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë/konsulentët e interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre siç parashihet më poshtë.

Ofertat duhen të shënojnë / ofrojnë informacionin e mëposhtëm shtesë:

- Duhet të shënohet numri i ftesës për ofertim,
- Duhet të shënohet data e ofertës,
- Duhet të ofrohet vlefshmëria e ofertës. (Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku 60 ditë),
- Për kompanitë duhet të ofrohen dokumentet zyrtare të kompanisë në vijim: Çertifikata e regjistrimit të biznesit, Informatat për biznesin, çertifikata fiskale dhe çertifikata e TVSH-së (të gjitha në kopje),
- Për konsulentët duhet të ofrohet: Kopja e Letënjoftimit,
- Oferta financiare duhet të jetë në Euro (pasi që projekti është i financuar nga fondet e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, rrjedhimisht oferta duhet të jetë pa TVSH sipas Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH neni 33).
- Duhet të ofrohen referencat mbi shërbime të ngjashme (minimum 3 referenca),
- Ofertat mund të përgatiten në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare në Kosovë apo në gjuhë angleze, Oferta duhet të dorëzohet përmes email-it në info@ickosovo.com. Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 24 Qershor 2020, ora 12:00.

***SHËNIM ME RËNDËSI:**

- i) Mosplotësimi i ndonjërit prej kushteve të detyrueshme për pjesëmarrje ju diskualifikon nga pjesëmarrja e mëtejme në vlerësim të Ofertës suaj.
- ii) Me rastin e nënshkrimit të kontratës, kompania/konsulenti/ja fituese duhet të prezentoj vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës që nuk ka borxhe, jo më të vjetër se 90 ditë.
- iii) Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë autoritetit kontraktues brenda afatit 7 (shtatë) ditë nga data e njoftimit.

KUSHTET DHE RREGULLAT E KUOTIMIT

- Oferta e kompletuar duhet të dorëzohet/dërgohet përmes email-it në info@ickosovo.com
- Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 24 Qershor 2020, ora 12:00.
- Për çdo pyetje, mund të dërgoni kërkesë me shkrim përmes email-it në këtë adresë: info@ickosovo.com. Pyetjet pranohej deri më 19 Qershor 2020.
- Hapja e ofertave do të bëhet më 24 Qershor 2020 ora 14:00 nga Komisioni përzgjedhës (i përbërë nga 3 anëtarë) dhe të gjitha palët e interesuara kanë të drejtë të jenë prezent gjatë hapjes në video-konferencë (kërkesa duhet të shtrohet gjatë aplikimit).
- Me rastin e hapjes së ofertave dhe në rast që shtrohet nevoja, Komisioni Vlerësues ka të drejtë të bëjë pyetje shtesë ndaj ofertuesve. Pyetjet do të komunikohen tek të gjitha palët.
- Ofertat do të vlerësohen në bazë të kritereve të mëposhtme kualitative dhe kuantitative.

Kriteret	Pikat sipas %
1. Ekspertiza e Kompanisë/Konsulentit dhe Eksperienca	40%
Eksperienca në monitorime	20 %
Eksperienca dhe ekspertiza e ekipit punues të propozuar	20 %
2. Financiare	60 %